

Rehan Neziri

RREGULLAT E EZANIT DHE TË IKAMETIT



Kreuzlingen 2025

Parathënie

Lexues të nderuar, es-selamu alejkum!

Që moti është ndjerë nevoja për një libër apo broshurë që do t'i përfshinte rregullat dhe parimet që duhet t'i ketë parasysh çdo person që e kryen punën e muezinit, qoftë ai të jetë muezin i rregullt qoftë jo i rregullt.

Andaj ne në këtë broshurë do të mundohemi që, përveç rregullave të muezinit e të muezinllëkut, sidomos për fillestarët të ofrojmë thuajse të gjitha tekstet që duhet t'i këndojë muezini, si në namazin ditor, ashtu edhe në namazet e tjera, si në: xhuma, bajram, teravi, etj.

Teksti do të jetë edhe me alfabet arab edhe me alfabet latin, i ndjekur vende-vende me përkthimin në gjuhën shqipe, me çka mëtojmë t'u ndihmojmë më shumë profileve të njerëzve, si fëmijëve, të rriturve, atyre që dinë të lexojnë arabisht, atyre që nuk dinë të lexojnë arabisht si dhe atyre që duan ta dinë kuptimin e asaj që e këndon muezini në raste të ndryshme.

Duhet theksuar se për bazë e kemi marrë formën e përgjithshme se si zbatohet muezinllëku nëpër xhamitë tona shqiptare në vendlindje dhe këtu në Perëndim. Prandaj, ne kërkojmë fuqishëm prej secilit që e merr përsipër muezinllëkun, ta ketë parasysh formën e muezinllëkut që zbatohet në xhaminë përkatëse dhe të mos shkaktojë tollovi duke sjellë forma të tjera nga xhami apo vise të tjera, pra të ruhet specifika e çdo xhamie.

Me shpresë se do të kemi kontribuar diçka në këtë drejtim dhe për fund e lusim All-llahun fuqiptotë që këtë vepër ta pranojë si shenjë përkushtimi ndaj Tij!

Mr. Rehan Neziri
Imam në Kreuzlingen
Zvicër, 2025

Disa njohuri të përgjithshme rreth ezanit dhe ikametit

Ezan (*arab.* edhan) nga aspekti gjuhësor do të thotë: “kumtim, informim”, kurse **ikamet** do të thotë: “ngritje për namaz”. Fjala **muezin** (*arab.* mu’edh-dhin) do të thotë: “njeriu apo personi i cili e thërret ezanin dhe bën ikametin”.

Thirrja e ezanit dhe ikameti për namazet farz kanë mbështetje si në Kur’an ashtu edhe në sunnetin e Muhammedit a.s. Siç është e njohur, në fillim muslimanët nuk kishin një ezan apo ikamet të këtillë. Për një kohë ata thërrisnin: **Es-salate, es-salate!** – *Në namaz, në namaz!* ose **Es-salatu xhamiatun** – *Namazi tubon (njerëzit)*. Pra, namazi është një mjet i cili siguron tubimin dhe afrimin e muslimanëve brenda shoqërisë islame.

Pasi Muhammedi a.s. dhe shokët e tij bënë hixhretin nga Mekka për në Medine, gjënë e parë që e bënë ishte ndërtimi i xhamisë fillimisht në Kuba, që sot njihet si *Mesxhidi Kuba* e pastaj edhe në Medine, e cila sot njihet me emrin *Mesxhidi Nebeviji*. Muslimanët filluan që rregullisht të tubohen e ta falin namazin me xhemat. Me këtë rast Muhammedi a.s. filloi ta diskutojë me shokët e vetë çështjen e kumtimit të kohëve të namazit për njerëzit, që ata ta dinin saktë se kur hy koha e namazit dhe kur do falet me xhemat në xhami. Dikush propozoi t’i bihej kambanës, dikush propozoi t’i fryhej borisë... etj., çka u refuzuan si simbole të feve të tjera, më në fund, duke u mbështetur në një ëndërr të vërtetë që e kishin parë njësoj disa shokë të Muhammedit a.s. dhe duke u mbështetur edhe në frymëzim (shpallje) nga Zoti, filloi të thirrej ezani i formës se si thirret tash e 14 shekuj. Edhe atë, meqë të gjitha vendet ku jetojnë muslimanët dallojnë nga njëra-tjetra nga aspekti kohor, nuk ka asnjë orë apo çast të njëzetekatërorëshit që në rruzullin tokësor të mos thirret ezani nga minaret e mrekullueshme të botës islame dhe të mos bëhet ikameti nëpër xhamitë madhështore, e kjo do të thotë edhe të mos falet namaz për Zotin. Çfarë detyre e shenjtë e thirrjes për në shpëtimin e Zotit është ajo e muezinit, çfarë da’veti i mrekullueshëm..!

Disa rregulla rreth ezanit dhe ikametit

1. Thirrja e ezanit për 5 kohët e namazit dhe të xhumasë është sunnet i fortë afër vaxhibit për meshkujt muslimanë. Ezani dhe ikameti ashtu siç janë sunnet për namazet e kohës, po ashtu sunnet janë edhe për namazet kaza. Sepse ezani dhe ikameti nuk janë sunnete të kohës, po të namazeve.
2. Nëse një person fal disa namaze kaza në vende të ndryshme, atëherë ai duhet të thërrasë ezan dhe ikamet për secilin namaz veç e veç. Mirëpo nëse disa namaze kaza i fal në një vend, atëherë sërish është më mirë që për secilin namaz kaza të thërrasë ezan dhe ikamet. Ndërkaq mundet edhe që ta thërrasë vetëm një ezan dhe për secilin namaz të bëjë ikamet veç e veç.
3. Ezani dhe ikameti të bëhen me fjalët si do t'i kemi sqaruar në faqet në vijim.
4. Për çdo namaz farz duhet (është sunnet i fortë) të thirret një ezan dhe të bëhet një ikamet. Vetëm në namazin e xhumasë ka dy ezane. Prandaj, nëse në një xhami apo në ndonjë vend tjetër është thirrur ezani dhe është bërë ikameti sipas rregullit dhe është falur namazi i kohës me xhemat, atëherë nëse më vonë aty vjen një grup njerëzish tjerë për ta falur namazin e asaj kohe me xhemat ose veç e veç, ata tanimë nuk duhet edhe një herë ta thërrasin ezanin dhe të bëjnë ikamet. Ata lidhen drejt në namaz.
5. Për namazin e vitrit, të bajramit, të teravisë, të sunneteve dhe të nafileve nuk duhet as ezan as ikamet.
6. Për namazet farz që falen në shtëpi ose në natyrë, më mirë është të thirret edhe ezani edhe të bëhet ikameti. Mund të mjaftohemi edhe me vetëm ikamet, mirëpo është mekruh të mjaftohemi vetëm me ezan pa ikamet.
7. Nuk lejohet të thirret ezani akoma pa hyrë koha e namazit. Nëse eventualisht është thirrur para kohe, ai ezan duhet të përsëritet pasi të hyjë koha e namazit përkatës.

8. Është mirë të lihet një distancë kohore midis ezanit dhe ikametit. Kështu për shembull pasi të thirret ezani i akshamit, duhet lënë një hapësirë kohore aq sa të lexohen nja 3 ajete të shkurtra, e pastaj të bëhet ikameti.
9. Nëse një person bën ikamet dhe pastaj ha, pi, lahet ose bën ndonjë punë tjetër para namazit, ai këtë ikamet duhet ta përsërisë. Nuk duhet të përsëritet ikameti nëse falësi i namazit apo imami gabon në namaz dhe duhet ta përsërisë namazin.
10. Muezini duhet të jetë një person që i njeh mirë rregullat e fesë dhe të jetë njeri i devotshëm. Është mekruh që ezanin ta thërrasë një xhahil (që ka shumë pak njohuri rreth fesë) dhe një fasik (i prishur moralisht).
11. Është mendub apo vaxhib të përsëritet ezani të cilin e ka kënduar i dehuri (pijaneci), i çmenduri, fëmija që nuk ka hyrë në bylyk (pubertet). Është mekruh, sipas një transmetimi, që ezanin ta thërrasë fëmija, qoftë të jetë edhe i mençur.
12. Është mekruh që ezani të thirret ulur. Nuk është mekruh kjo nëse ezanin e thërret vetëm për vete, pra për namazin që do ta falë vetë.
13. Është mekruh të thërrasin ezan e të bëjnë ikamet këta persona: gruaja, i çmenduri dhe xhunubi (personi që duhet të marrë gusël). Ikameti i këtyre personave nuk duhet përsëritur, mirëpo ezani po. Është mekruh të bëjë ikamet personi që nuk ka abdest.
14. Muezini duhet ta shikojë gjendjen e xhematit. Nëse xhemati kërkojnë që namazin ta falin në fillim të kohës së tij, atëherë muezini nuk duhet të presë ardhjen e të parit të katundit apo të mëhallës apo dikë tjetër...
15. Kur muezini e thërret ezanin duhet të qëndrojë në këmbë dhe të jetë i kthyer kah kibla. Kur të thotë: **“Hajje ales-salah”** (“Ejani në namaz!”), kthehet kah ana e djathtë, kurse kur të thotë: **“Hajje alel-felah”** (“Ejani në shpëtim!”), kthehet nga ana e majtë. Kurse kur është në minare sipas situatës, nga ana e djathtë rrotullohet drejt anës së majtë dhe e përfundon ezanin.

Për të ndihmuar shtimin e zërit, muezini i fut në veshë majat e dy gishtave të tij.

16. Është mekruh që gjatë ikametit muezini ta pastrojë fytin e tij me të kollitur (tenehnuh), përveç kur duhet ta shtojë dhe zbukurojë zërin e tij. Është mekruh po ashtu që muezini të flasë midis ezanit dhe ikametit, bile nuk e merr as edhe selamin që ia jep dikush.
17. Përderisa thirret ezani, ata që e dëgjojnë duhet të heshtin dhe duhet t'i ndërpresin të gjitha bisedat tjera. Bile edhe ai që lexon Kur'an është më mirë ta ndërpresë leximin e Kur'anit dhe ta dëgjojë ezanin. Ndërkaq ai që lexon Kur'an (mukabele) në xhami, ai mund të vazhdojë leximin dhe të mos e dëgjojë ezanin.
18. Personi i cili e dëgjon ezanin dhe ikametin, është mustehab t'i përsërisë fjalët që i këndon muezini. Përveç kur muezini të thotë: **“Hajje ales-salah”** dhe **“Hajje alel-felah”**, dëgjuesi në vend të këtyre fjalëve thotë: **“La haule ve la kuvvete il-la bil-lahil alijil adhim”**¹, ndërsa kur në ezanin e sabahut muezini të thotë: **“Es-salatu hajrum minen neum”** (“Namazi është më i mirë se gjumi”), dëgjuesi i ezanit duhet të thotë: **“Sadekte ve berarte”**².
19. Gjatë faljes së namazit me xhemat, të gjithë pa përjashtim duhet t'i përsërisin të gjitha ato që i lexon muezini, si para namazit ashtu edhe pas namazit, pra me rastin e heqjes së tesbihëve (Shiko më poshtë “Dhikret pas namazit”).
20. Secili musliman që e dëgjon ezanin, në fund të ezanit e lexon “Duanë e ezanit” (Shih më poshtë pas ezanit). Me këtë dua muslimani shpreson në shefatin (ndërmjetësimin) e Pejgamberit a.s. në Ahiret.
21. Ezani i akshamit thirret gjithnjë pak më shpejtë se ezanet e kohëve të tjera.

¹ „Nuk ka forcë e fuqi pos asaj të All-llahut të Madh”.

² „E ke tamam dhe ke thënë një fjalë të mirë“.

EZANI

الْأَذَانُ

All-llahu ekberull-llahu ekber
All-llahu ekberull-llahu ekber

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ

Esh-hedu el-la ilahe il-lall-llah
Esh-hedu el-la ilahe il-lall-llah

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ

Esh-hedu en-ne Muhammeder
Rasulull-llah
Esh-hedu en-ne Muhammeder
Rasulull-llah

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ

أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ

Hajje ales-salah
Hajje ales-salah

حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ

Hajje alel felah
Hajje alel felah

حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ

(Es-salatu hajrum minen neum
Es-salatu hajrum minen neum)
Kjo lexohet vetëm në namazin e sabahut)

حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ

حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ

All-llahu ekberull-llahu ekber
La ilahe il-lall-llah.

(الصَّلَاةُ خَيْرٌ مِنَ النَّوْمِ)

(الصَّلَاةُ خَيْرٌ مِنَ النَّوْمِ)

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Duaja e ezanit:

اللَّهُمَّ رَبَّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ التَّامَّةِ وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ آتِ مُحَمَّدَانَ الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ
وَالدَّرَجَةَ الرَّفِيعَةَ وَابْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَهُ، إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ.

“All-llahumme Rabbe hadhihid-da’vetit-tammeh ve’s-salatil kaimeh, ati Muhammedeni’l-vesilete ve’l-fadilete ve’d-deraxheter-rafi’ah veb’ath-hu mekamem-mahmudeni’l-ledhi ve’at-teh, inneke la tuhlifu’l-mii’ad”.

Përkthimi:

“O All-llahu im! Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që afrohet! Jepi Muhammedit a.s. ndërmjetësimin, vlerën dhe shkallën e lartë dhe dërgoje atë në vendin e lavdëruar që Ti ia ke premtuar. Ti, vërtet, nuk e thyen premtimin!”.

**Pasi të falen sunnetet e para të namazit, pra para çdo farzi,
muezini bën ikametin:**

الْإِقَامَةُ

IKAMETI

**All-llahu ekberull-llahu ekber
All-llahu ekberull-llahu ekber**

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ
اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ

**Esh-hedu el-la ilahe il-lall-llahu
Esh-hedu el-la ilahe il-lall-llah**

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ
أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

**Esh-hedu en-ne Muhammeder
Rasulull-llahi
Esh-hedu en-ne Muhammeder
Rasulull-llah**

أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ
أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ

**Hajje ales-salati
Hajje ales-salah**

حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ
حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ

**Hajje alel felahi
Hajje alel felah**

حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ
حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ

**Kad kametis-salatu
Kad kametis-salah**

قَدْ قَامَتِ الصَّلَاةُ
قَدْ قَامَتِ الصَّلَاةُ

**All-llahu ekberull-llahu ekber
La ilahe il-lall-llah.**

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Dhikret pas namazit

Mbasi imami të japë selam pas çdo namazi të falur me xhemat, muezini thotë:

اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمِنْكَ السَّلَامُ تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

“All-llahumme entes-selamu ve minkes-selamu tebarakte, ja dhel xhelali vel ikram”.

Pastaj, nëse ka sunnet falen edhe ato e pastaj muezini thotë:

عَلَى رَسُولِنَا صَلَوَاتٌ “Ala rasulina salavat...”

Secili lexon në vete: “All-llahumme sal-li ala Muhammed...” ose në disa xhami imami e lexon me zë edhe “Salatun tunxhiina”, e cila është:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ صَلَاةً تُنَجِّنَا بِهَا مِنْ جَمِيعِ الْأَهْوَالِ وَ
الْآفَاتِ وَتَقْضِي لَنَا بِهَا جَمِيعَ الْحَاجَاتِ وَتُطَهِّرُنَا بِهَا مِنْ جَمِيعِ السَّيِّئَاتِ وَتَرْفَعُنَا بِهَا عِنْدَكَ أَعْلَى
الدَّرَجَاتِ وَتُبَلِّغُنَا بِهَا أَقْصَى الْغَايَاتِ مِنْ جَمِيعِ الْخَيْرَاتِ فِي الْحَيَاةِ وَبَعْدَ الْمَمَاتِ.

“All-llahumme sal-li ala sej-jidina Muhammedin ve ala ali sej-jidina Muhammed, salaten tunxhina biha min xhemi’il ehvali vel-afat, ve takdi lena biha xhemi’al-haxhat, ve tutah-hiruna biha min xhemi’is-sejjiat, ve terfeuna biha ‘indeke a’lederaxhat, ve tubel-liguna biha aksal-gajat min xhemi’il-hajrati fil-hajati ve ba’del-memat”.

Pastaj muezini vazhdon duke lexuar:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ.

“Subhanall-llahi vel hamdu lil-lahi ve la ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber. Ve la haule ve la kuvvete il-la bil-lahil alijil adhim”.

Secili pa zë e lexon: “Ajetul-kursijjen” ose “All-llahu la ilahe il-la hu...” (Ajeti 255 i sures el-Bekara)

Pastaj muezini vazhdon:

وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ ذُوالْجَلَالِ وَالْجَمَالِ سُبْحَانَ اللَّهِ

“Ve huvel alijjul adhimu dhul xhelali vel xhemali Subhanall-llah” (secili thotë pa zë 33 herë “Subhanall-llah”)

سُبْحَانَ الْبَاقِي دَائِمًا الْحَمْدُ لِلَّهِ

“Subhanel baki daimenil hamdu lil-lah” (33 herë “el-hamdu lil-lah”)

رَبِّ الْعَالَمِينَ تَعَالَى شَانُهُ اللَّهُ أَكْبَرُ

“Rabbil alemine teala shanuhull-llahu ekber” (33 herë “All-llahu ekber”)

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ.

“La ilahe il-lall-llahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kul-li shej'in kadir”

(Bëjmë duanë dhe kur imami përfundon duanë dhe e lëmon fytyrën, muezini thotë):

وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ الْفَاتِحَةُ

“Vel hamdu lil-lahi rabbil alemin el-fatihah”.

Te namazi i sabahut dhe i jacisë në disa xhami muezini thotë vetëm: **“Vel hamdu lil-lahi rabbil alemin...”** e pastaj imami apo muezini e lexon “La

jestevi...” (el-Hashr: 20-24) në namazin e sabahut dhe “Amener-rasulu...” (el-Bekara:285-286) në namazin e jacisë.

Te namazi i xhumasë

Sa hyn koha e xhumasë, muezini e thërret ezanin si për çdo namaz tjetër, pastaj i falin 4 sunnet të xhumasë, dhe pasi imami (hatibi) të hipë në minber, muezini e thërret edhe një herë ezanin brenda në xhami, e kur hatibi ta përfundojë hutben, muezini bën ikamet dhe gjithçka tjetër vazhdon si në namazet tjera.

Te namazi i Bajramit

Në fillim thirret ezani i sabahut, falet sunneti dhe farzi i sabahut si çdo ditë tjetër, pastaj imami mban ligjëratën (dersin) e Bajramit. Në fund të këtij dersi imami i njofton xhematin për mënyrën se si falet namazi i Bajramit. E falin namazin ashtu si e tregon imami, pas selamit muezini thotë: **“All-llahumme entes-selamu ve minkes-selamu tebarakte ja dhel xhelati vel ikram”** dhe bashkë me xhematin i lexojnë me zë 3 herë tekbiret:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ، اللَّهُ أَكْبَرُ وَلِلَّهِ الْحَمْدُ.

“All-llahu ekberull-llahu ekber. La ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber. All-llahu ekberu ve lil-lahil hamd”.

Imami e mban hutben dhe duke zbritur ai nga minberi për të shkuar te mihrabi për ta bërë duanë e bajramit, muezini lexon:

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

„Ve ma erselnake il-la rahmetel lil alemin“

Kur imami përfundon duanë dhe e lëmon fytyrën, muezini thotë):

وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ الْفَاتِحَةُ

“Vel hamdu lil-lahi rabbil alemin el-fatihah”.

Te namazi i teravisë

Në fillim muezini e thërret ezanin, pastaj i falin 4 sunnet, 4 farz dhe 2 sunnet të mbrëmë të jacisë si rregullisht, e pastaj kur çdokush i ka falur këto sunnete muezini lexon:

عَلَى رَسُولِنَا صَلَوَاتٍ، اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ.

“Ala Rasulina salavat, All-llahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed”.

Bashkë me imamin lidhen në namazin e teravisë.

Kur imami jep selam në krye të 4 rekateve, muezini bashkë me xhemat thonë:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ. اللَّهُ أَكْبَرُ وَلِلَّهِ الْحَمْدُ.

“All-llahu ekberull-llahu ekber. La ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber. All-llahu ekberu ve lil-lahil hamd” (1 herë). Mbasandaj muezini më shpejt thotë:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ

“All-llahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed” (lidhen në 4 rekatet tjera).

Në selamin e dytë 1 herë lexohet bashkë me xhematin:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ. اللَّهُ أَكْبَرُ وَلِلَّهِ الْحَمْدُ.

“All-llahu ekberull-llahu ekber. La ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber. All-llahu ekberu ve lil-lahil hamd” (1 herë). Mbasandaj muezini më shpejt thotë:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ

“All-llahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed” (lidhen në 4 rekatet tjera).

Në selamin e tretë 1 herë lexohet bashkë me xhematin:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ. اللَّهُ أَكْبَرُ وَلِلَّهِ الْحَمْدُ.

“All-llahu ekberull-llahu ekber. La ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber. All-llahu ekberu ve lil-lahil hamd” (1 herë). Mbasandaj muezini më shpejt thotë:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ

“All-llahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed” (lidhen në 4 rekatet tjera).

Në selamin e katërt 1 herë lexohet bashkë me xhematin:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ نِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ وَسَلِّمْ.

“All-llahumme sal-li ala sejjidina Muhammedinin Nebijjil ummijji ve ala alihi ve sahibi ve sel-lim”.

Kur ta japë imami selamin e fundit, muezini lexon:

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَى وَالْفُرْقَانِ ...

ose

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ.

“Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir raxhim, Bismil-lahir Rahmanir Rahim

Shehru Ramadanel-ledhi unzile fihil Kur’an, Hudel-lin-nasi ve bejjinatim minel huda vel furkan” (ose: Ve ma erselnake il-la rahmetel lil-alemin):

Imami i ngren duart dhe e lexon duanë e taravisë. Kur e lëmon fytyrën muezini thotë:

وَسَلَامٌ عَلَى الْمُرْسَلِينَ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ.
اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ.

“Ve selamun alel murseline vel hamdu lil-lahi Rabbil alemin. All-llahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed”.

Ngrihen në këmbë dhe lidhen për ta falë namazin e vitrit. Kur imami mbaron me këtë namaz dhe jep selam, muezini thotë sikurse mbas çdo namazi tjetër:

اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمِنْكَ السَّلَامُ تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

“All-llahumme entes-selamu ve minkes-selamu tebarakte ja dhel xhelali vel ikram”.

Mbasandaj vazhdon me tesbihët dhe duanë e namazit sikurse në namazin e rregullt të jacisë.

All-llahu i pastë bërë kabull të gjitha ibadetet! Amin!